



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:094732

Datë: 13.05.2024

Numri i dokumentit: 05697294

Ac.nr.8164/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hysni Bardheci, kryetar i kolegjit, Bujar Muzaqi dhe Enes Mehmeti, anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Robertina Lekaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësve S.Th., S.Z., S.M., M.I. dhe S.B., që të gjithë nga Prizreni, të cilët i përfaqëson me autorizim B.K., avokat në Prizren, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt të kontestit kompensimi i ushqimit gjatë punës, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.830/2021, të datës 31.10.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 30.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e Prizrenit–Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.830/2021, i datës 31.10.2022, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.830/2021, të datës 31.10.2022, ka vendosur si në vijim: “Detyrohet e paditura Komuna e Prizrenit, në emër të kompensimit të shujtave për paditësit S.Th. nga Prizreni, për 185 ditë pune, në emër të shujtave t’i kompenson nga 2.00 € për ditë pune, gjithsejtë për 185 ditë shumën 370.00 €, S.Z. nga Prizreni, për 185 ditë pune, në emër të shujtave t’i kompenson nga 2.00 € për ditë pune, gjithsejtë për 185 ditë shumën 370.00 €, S.M. nga ..., Komuna e Prizrenit, për 185 ditë pune, në emër të shujtave t’i kompenson nga 2.00 € për ditë pune, gjithsejtë për 185 ditë shumën 370.00 €, M.I. nga Prizreni, për 185 ditë pune, në emër të shujtave t’i kompenson nga 2.00 € për ditë pune, gjithsejtë për 185 ditë shumën 370.00 € dhe S.B. nga Prizreni, për 185 ditë pune, në emër të shujtave t’i kompenson nga 2.00 € për ditë pune, gjithsejtë për 185 ditë shumën 370.00

€. Si dhe në emër të shpenzimeve të procedurës shumë prej 332.00 € të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi”.

Kundër këtij aktgjykimi, e paditura në afat ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim Gjykatës së Apelit të Kosovës, ankesën e të paditurës ta aprovoj si të bazuar, të prish aktgjykimin C.nr.830/2021 të datës 31.10.2022, dhe të hedh poshtë padinë e paditësve apo të ndryshoj aktgjykimin e atakuar ose të njëjtin ta prish dhe çështja t’i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Përgjigje në ankesë nuk kanë ushtruar paditësit.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit, përmes të autorizuarit të tyre, kundër të paditurës, kanë parashtruar padi me datën 19.05.2021, për kompensimin e ushqimit gjatë punës (shujtave), duke kërkuar që të aprovohet kërkesëpadija ashtu që të detyrohet e paditura që paditësve t’ua paguaj shumat si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar. E paditura, me anë të përgjigjes në padi, ka kontestuar kërkesëpadinë e paditësve, duke propozuar që e njëjta të refuzohet në tërësi si e pa bazuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësve, pas shqyrtimit të padisë dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 152 të LPK-së, ka gjetur se janë plotësuar kushtet për dhënin e aktgjykimin pa shqyrtim kryesor të çështjes, dhe ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.830/2021, të datës 31.10.2022, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimin të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka konstatuar së nga shqyrtimi i shkresave të lëndës dhe vërtetimet e lëshuara nga SHFMU “Lekë Dukagjini”, në Prizren, është vërtetuar që gjatë vitit 2019, paditëset kanë punuar si mësimdhënës pran asaj shkolle, dhe se për këtë vit kanë pasur nga 185 ditë aktive të punës. Në kuptim të nenit 35 par. 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit, punëtorëve të arsimit ju njihet e drejta në kompensim të shpenzimeve të ushqimit në punë për një ditë pune të pranishme në punë në shumë 2.00 €, me kusht që punëdhënësi të mos ketë të organizuar përmes restorantit apo kuzhinës në vendin e punës. Në rastin konkretë paditësit gjatë vitit 2019 kanë qenë të pranishme në punë 185 ditë, ashtu që nga 2.00 € në ditë për 185 ditë gjithsejtë kanë të drejtë të kompensohen në shumë e përgjithshme secili veç e veç nga 370.00 €. Tutje gjykata ka arsyetuar së në kuptim të nenit 152 të LPK-së gjykata pa shqyrtim kryesor mund të jep aktgjykim me kusht që pala e paditur t’i pohon faktet pavarësisht kundërshtimit të kërkesëpadiës. Në rastin konkretë pala e paditur e pohon faktin që sipas

kontratës Kolektive të Arsimit, të punësuar kanë të drejtë në kompensim. Gjithashtu pohon faktin që paditëset janë punëtore të arsimit dhe kanë qenë të pranishme në punë për vitin 2019, 185 ditë. Si dhe faktin që për ato ditë nuk janë kompensuar. Pavarësisht se e kundërshton kërkesëpadinë me arsyetimin që Komuna nuk ka detyrim që të kompensojë këtë të drejtë pasi që nuk ka qenë nënshkruese e asaj kontrate. Nga këto arsye gjykata ka vendosur që të aprovojë kërkesëpadinë dhe të obligojë të paditurën që paditësve t'iu kompensojë shumat e përshkruara si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Vendimin për shpenzimet e procedurës, gjykata ka arsyetuar se ka vendosur konform dispozitive të nenit 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitive të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitive të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës për shkelje të dispozitive të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2, pika n) dhe o) të LPK-së, pasi që me rastin e hartimit të aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme për mënyrën e vendosjes në këtë çështje juridike kontestimore, duke arsyetuar të gjitha faktet vendimtare të cilat kanë ndikuar që e njëjta të vendos si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, të cilat arsye janë të pranueshme edhe për gjykatën e shkallës së dytë. Dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin dhe së gjykata ka vendosur brenda kufijve të kërkesëpadisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsye të duhura për marrjen e aktgjykimit pa shqyrtim kryesor të çështjes siç parashihet me nenin 152 të LPK-së, pasi që e paditura përmes përgjigjes në padi nuk e ka kontestuar gjendjen faktike dhe së në këtë rast nuk kanë ekzistuar pengesa tjera për dhënien e vendimit meritor.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë e ka vërtetuar gjendjen faktike, pasi që nuk është kontestuese se paditësit janë të punësuar tek e paditura, përkatësisht në Shkollën Fillore të Mesme të Ulët "Lekë Dukagjini" në Prizren, dhe kjo e fundit nuk iu ka ofruar paditësve ushqim në punë përmes restorantit, kuzhinës apo ndonjë formë tjetër, ndërsa nga provat e bashkangjitura është vërtetuar se paditësit për vitin 2019, kanë nga 185 ditë të pranisë në punë secili.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, pasi që në bazë të nenit 35 par.7, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e cila ka hyrë në fuqi me datën 18.04.2017, përcaktohet se *"Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim, gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro, për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim*

kompensimin për ushqim". Në rastin konkret, duke pasur parasysh se nga gjendja faktike e vërtetuar rezulton se paditësit kanë realizuar ditët e punës siç janë të theksua më lart, gjë që është vërtetuar sipas vërtetimeve të lëshuara nga Shkolla Filllore e Mesme të Ulët "Lekë Dukagjini", në Prizren, ndërsa e paditura nuk u ka ofruar paditësve ushqimin gjatë punës përmes restorantit, kuzhinës apo në ndonjë formë tjetër, atëherë mbi bazën e të lartcekurave, kjo gjykatë gjeti se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësve si të bazuar, duke ia njohur shumat përkatëse të kompensimit për ushqimin gjatë ditëve të pranisë në punë secilit paditës veç e veç, andaj edhe vendosi që të njëjtin ta vërtetoj sikurse në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Sa i përket pretendimit së e paditura nuk ka obligim ndaj paditësve pasi që e njëjta nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, Gjykata e Apelit, gjeti se ky pretendim është i pabazuar, pasi që në bazë të nenit 90 paragraf 1 të Ligjit NR.03/L-212 të Punës është paraparë së "Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: 1.1. organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe 1.2. organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve". Sipas paragrafit 2 të këtij neni përcaktohet së "Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: 2.1. nivel të vendit, 2.2. nivel të degës, 2.3. nivel të ndërmarrjes". Ndërsa në bazë të nenit 2 par.1.2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e cila është nënshkruar nga MASHT-it dhe SBASHK, është paraparë së "Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat- DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës". Duke qenë së e paditura në këtë rast është punëdhënës i paditësve, Gjykata e Apelit vlerëson së e njëjta ka për obligim që t'ia bëjë kompensimin e ushqimit për ditët e pranisë në punë, ndërsa koordinimi në mes të nivelit qendror dhe lokal në drejtim të alokimit të mjeteve për këtë kategori të pagesave që buron nga Kontrata Kolektive është çështje e brendshme e të paditurës me nivelin qendror dhe kjo assesi nuk mund të afekton në të drejtën e paditësve dhe detyrimin e të paditurës.

Lidhur me pretendimin ankimor së paditësit nuk i ka shterur mjetet e brendshme në procedurë administrative para se të dorëzohet padia në gjykatë, Gjykata e Apelit, gjeti se ky pretendim nuk qëndron, pasi që nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës rezulton se paditësit me kërkesa të veçanta i janë drejtuar të paditurës duke kërkuar kompensimin e shujtave ditore për vitin 2019, gjithsejtë për nga 185 ditë punë për secilin paditës, duke kërkuar shumën prej nga 370 euro, dhe meqenëse e paditura nuk iu është përgjigjur kërkesave të paditësve, të njëjtit kanë ushtruar padi në gjykatë. Për me tepër, kjo gjykatë vlerëson së e paditura ka pasur për obligim që paditësve t'ia paguaj kompensimin për ditët e pranisë në punë pa pasur nevojë që paditësit t'i drejtohet me kërkesë, dhe së në rastet kur kemi të bëjë me kërkesat në para, siç është rasti konkret, mos parashtrimi i kërkesës tek punëdhënësi nuk paraqet pengesë që i punësuar, në këtë rast paditësit për realizimin e të drejtës së tyre t'i drejtohet gjykatës me padi.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo konsideroi se të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese dhe në pajtim me dispozitat e nenit 449, 452.1, dhe 453 të LPK-së.

Nga të lartcekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195, paragrafi 1, pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-PRISHTINË

Ac.nr.8164/2022, datë 30.04.2024

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari
Hysni Bardheci